



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 150, Datë 25.07.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN’S MIRACLE”
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1652/1 prot., datë 24.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SUN’S MIRACLE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1652 prot., datë 17.07.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2MW dhe veprave ndihmëse, në Zonën Kadastrale Nr. 3358, Fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “b”, “c”, “d” dhe “f”.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare ku të sqarojë/saktësojë me cilat fonde është bërë pagesa kundrejt sipërmarrësit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “a”**: Përsa i përket numrit të njërive gjeneruese dhe kapacitetit të instaluar të secilës, sa plotësuar nga shoqëria rezulton se tejkalohet kapaciteti total i përcaktuar në kontratën me MIE dhe lejet e tjera që disponon, ndaj do t'i kërkohet shoqërisë të bëjë saktësimet përkatëse. Gjithashtu duhet të depozitojë dokumentacionin teknik mbështetës në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaiik.
- **gërma “e”**: Subjekti ka depozituar VNM-në, e cila sipas afateve të vlefshmërisë rezulton se subjekti duhet të kishte filluar punimet brenda datës 24.06.2024. Gjithashtu subjekti ka depozituar në ERE me vullnetin e tij dhe lejen e ndërtimit të datës 16.04.2024, por nga sa analizuar, subjekti nuk ka bërë me dije nëse ka nisur ndërtimin apo fazën në të cilën ndodhet, si e tillë vlerësohet të pyetet në vijim me qëllim edhe përlllogaritjen dhe vlerësimin e vlefshmërisë së kësaj VNM-je në kuadër të këtij aplikimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI